



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14325 Prot.

Lezhë, më 30.07. 2021

VENDIM

Nr. 122 Datë 29.07. 2021

Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021 dhe PBA-në 2021-2023

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; dhe të VKM nr.215, datë 31.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në Bashkinë Lezhë, dhe caktimin e bashkisë si njësi zbatuese”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

- Miratimin e një shtesë në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 dhe vitet 2022-2023, si më poshtë:
 - Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2021 në shumën 17,835,093 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 71,340,374 lekë.
 - Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Planifikimi Urban Vendor” për vitin 2021 në shumën 17,835,093 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 71,340,374 lekë, respektivisht:
 - Për punimet e ndërtimit të njësive individuale të banimit për vitin 2021 në shumën 17,835,093 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 71,340,374 lekë.Veprimet të kryhen si më poshtë :
 - Pakësohet : Gr.00, Prog.04960, Kap.01, Art.604, për vitin 2021 në shumën 17,835,093 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 71,340,374 lekë.
 - Shtohet : Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.231, për vitin 2021 në shumën 17,835,093 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 71,340,374 lekë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

